

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Asistent-lektor” pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Departamenti i Burimeve të Energjisë, në fushën e “Hidraulikës dhe Shpimit/Fluideve Teknologjike në Shpimin e Puseve”.

Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektor” pranë Departamentit të Burimeve të Energjisë, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet “Master i Shkencave”/DIND në Degën “Inxhinieri Naftë dhe Gazi”/ “Inxhinieri e Burimeve të Energjisë”, FGJM-UPT;
2. Të kenë notë mesatare mbi 8.00/10.00;
3. Të njohin një gjuhë të huaj (Anglisht, Gjermanisht, Frengjisht apo Italisht, preferohet gjuha Angleze), e dokumentuar me dëshminë përkatëse;
4. Të njohin dhe përdorin lehtësisht Programet Standarde të Paketës Microsoft Office, ACAD, si dhe Programe/Softë të tjera specifike profesionale;
6. Preferohet të kenë përvojë pune (me përparësi në Sektorin e Industrisë së Naftës);
7. Veprimtaria Shkencore dhe Botime përbëjnë përparësi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Fotokopje e Diplomës dhe listës së notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **01.04.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.